



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë

Adresa: Bulevardi: “Zhan D’Ark” Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. **Prot.** **Tiranë 27/03/2020**
Nr. Dok.

Lënda: *Rekomandim për marrjen e disa masave për të siguruar aksesin në informacion si dhe shërbim të shtetasve sa i përket kufizimit/ndalimit të së drejtës për lëvizje, gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19.*

KOMITETIT NDËRMINISTROR TË EMERGJENCAVE CIVILE
Tiranë

MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
Tiranë

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË POLICISË SË SHTETIT
Tiranë

Të nderuar,

Institucioni i Avokatit të Popullit, në përmbushje të misionit të tij kushtetues, mbrojtjes dhe garantimit të të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve shqiptarë dhe të huaj që banojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë, veçanërisht në këtë kohë mjaft të vështirë që po kalon vendi për shkak të përhapjes së sëmundjes infektive COVID-19, është duke monitoruar me shumë kujdes masat e marra nga autoritetet shtetërore për parandalimin e përhapjes së kësaj sëmundje infektive, si edhe rastet e ndryshme të mosrespektimit apo mosgarantimit të të drejtave themelore të njeriut në atë masë që janë të pakufizueshme apo të pakufizuara nga aktet normative të nxjerrë për këtë qëllim.

Më datë 31 Janar 2020 Organizata Botërore e Shëndetësisë shpalli gjendjen e emergjencës shëndetësore globale, për shkak të përhapjes së këtij virusi me ritme tejet të shpejta. Më pas, si pasojë e përhapjes së tij me ritme e pasoja të paparashikuara, më datë 11 Mars 2020, Organizata Botërore e Shëndetësisë shpalli gjendjen e pandemisë botërore.

Shpallja e kësaj gjendje e ka vendosur vendin tonë në një situatë e cila ka shkaktuar ndërprerje e një pjese thelbesore të aktivitetit të përgjithshëm shoqëror dhe ekonomik apo zhvillimin e tij për sa është e mundur nëpërmjet telepunës. Megjithatë, në funksion të ushtrimit të detyrës kushtetuese që na është besuar, jemi të vetëdijshëm se të drejtat e njeriut nuk mund të jenë dytësore edhe në një situatë pandemie.

Rregullat dhe aktivitetet për zbulimin në kohë, evidentimin, parandalimin, kontrollin, eliminimin dhe zhdukjen e sëmundshmërisë dhe të vdekshmërisë nga infeksionet dhe sëmundjet infektive në Republikën e Shqipërisë, përcaktohen në ligjin nr. 15/2016 “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”.

Ky ligj përcakton kufizimin e disa prej të drejtave të qytetarëve, me qëllim mbrojtjen e shëndetit publik. Kufizime të tilla mund të jenë mbyllja e shkollave; mbyllja e aktiviteteve jopublike apo publike; anulimi i grumbullimeve masive në vende të mbyllura apo të hapura; kufizimi apo ndalimi i lëvizjeve me mjetet e transportit publik; kufizimi i lëvizjeve brenda vendit, etj.

Autoriteti publik i autorizuar nga ky ligj për kufizimin e disa të drejtave në rastin e një pandemie, është ministri përgjegjës për shëndetësinë, si edhe Këshilli i Ministrave (pas propozimit të ministrit përgjegjës për shëndetësinë). Ky ligj përcakton që masat kufizuese duhet të jenë proporcionale e kenë për qëllim mbrojtjen e popullatës nga sëmundja përkatëse.

Rregullat që aplikohen gjatë periudhës së pandemisë kanë për qëllim ndërgjegjësimin dhe detyrimin e qytetarëve për të mos u angazhuar në aktivitete të cilat përbëjnë rrezik për përhapjen e sëmundjes, duke vendosur edhe kufizime në ushtrimin e disa të drejtave. Këto rregulla përfshijnë edhe të drejtën e autoriteteve shtetërore shëndetësore për të identifikuar qytetarët të cilët potencialisht mund të jenë mbartës të sëmundjes, dhe për të ushtruar tek ta kontrollet e nevojshme shëndetësore. Të gjitha këto veprime të autoriteteve duhet të kryhen duke respektuar në çdo rast të drejtat e njeriut.

Si pasojë e situatës së krijuar në vendin tonë dhe me qëllim mbrojtjen e popullatës nga kjo sëmundje, nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë janë përcaktuar një sërë masash kufizuese me Aktin Normativ Nr. 3, datë 15.3.2020 “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19”, të ndryshuar. Sa i përket kufizimit të qarkullimit të automjeteve, në nenin 3 të tij “Masat e veçanta administrative”, në pikën 11 është parashikuar se:

“Drejtuesit e automjeteve, të cilët nuk zbatojnë ndalimin e qarkullimit të mjeteve të transportit, publik dhe privat, përfshirë automjetet private, në zonat dhe oraret e përcaktuara nga organet kompetente, dënohen me heqje të lejes së drejtimit për një periudhë trevjeçare dhe me bllokim të mjetit. Nga ky rregull përjashtohen personat e autorizuar nga organet kompetente.”

Nga përmbajtja e këtij neni kuptohet se do të ndalohet qarkullimi me automjete të transportit publik dhe privat, përfshirë edhe automjetet private në zonat dhe oraret e përcaktuara nga organet kompetente.

Duke iu referuar nenit 4 “Organet kompetente për dhënien e masave administrative” kuptohet që, organi kompetent për dhënien e autorizimeve drejtuesve të mjeteve për të lëvizur jashtë zonave dhe orareve të përcaktuara nga autoritetet, është Policia e Shtetit.

Ndërsa nga media “Shqiptarja.com” në datën 15.03.2020¹ jemi informuar se, Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka nxjerrë Urdhrin nr. 168/1, datë 15.03.2020 “Për kufizimin e lëvizjeve brenda vendit”, i cili ka hyrë në fuqi menjëherë.

Sipas pikës 1 të këtij urdhri, ndalohej lëvizja me mjetet e transportit publik dhe privat të udhëtarëve qytetas, ndër-qytetas dhe rreth qytetas deri në një urdhër të dytë.

Sipas pikës 2, përjashtim nga rregulli i pikës 1 bëjnë mjetet e transportit të pajisura me autorizim të posaçëm nga autoritetet kompetente dhe mjetet e transportit të institucioneve publike dhe/ose private të cilat lejohen të qarkullojnë në intervalet 05:00 deri në orën 08:00 dhe midis intervalit kohor nga ora 16:00 deri në orën 17:00.

Sipas pikës 3 të tij, për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Inspektorati Shtetëror Shëndetësor dhe strukturat e Policisë së Shtetit dhe të Policisë Bashkiake.

Sqarojmë se nga referimi i akteve ligjore mbi bazën e të cilit ai ka dalë rezultojnë se është nxjerrë para miratimit të aktit normativ të cituar më sipër dhe është bazuar në ligjin nr. 15/2016 “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”.

Gjithashtu po nga media “Balkanweb” në datën 20.03.2020² jemi informuar se, Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka nxjerrë edhe Urdhrin nr. 193, datë 20.03.2020, “Për mbylljen apo kufizimin e lëvizjeve në Republikën e Shqipërisë”, i cili ka hyrë në fuqi menjëherë.

Ndërsa në faqen zyrtare të Policisë së Shtetit gjendet i publikuar akti normativ nr. 3, datë 15.3.2020, si dhe një njoftim i bërë në datën 16.03.2020 me titull, “Sqarim i Policisë së Shtetit” ku thuhet se:

"Nisur nga fluksi i madh i telefonatave të qytetarëve drejt numrave të dedikuar 069 41 22223 dhe 069 41 22224, si dhe nga email-et e shumta të ardhura në adresën e dedikuar: policiarrugore@asp.gov.al, për akreditim apo informacione të ndryshme në lidhje me masat kufizuese për mospërhapjen e COVID-19, sqarojmë gjithë qytetarët se:

Të gjithë pronarët e bizneseve prodhuese apo ata që ofrojnë shërbime për qytetarët, të cilët duan të akreditojnë automjetet për lëvizje personeli apo mallra brenda qarkut, të mos dërgojnë email në adresën policiarrugore@asp.gov.al dhe as të mos telefonojnë në dy numrat e dedikuar, por t'i drejtohen Sektorit të Policisë Rrugore të qarkut ku kanë vendbanimin dhe ushtrojnë aktivitetin e tyre.

Ndërsa ata pronarë apo administratorë që kanë aktivitet/biznes edhe jashtë qarkut, si dhe ata që banojnë në qarkun Tiranë, të vazhdojnë të bëjnë kërkesa për akreditim nëpërmjet email-it policiarrugore@asp.gov.al dhe dy numrave të dedikuar.

Orari i lëvizjes 06:00 deri 08:00 dhe në pasdite 16:00 deri në 17:00 nuk është për lëvizjen e lirë të qytetarëve, por për personelin/ punonjësit e ndërmarrjeve prodhuese, të cilët do lejohen të kenë aktivitet, sipas konfirmimeve të bëra nga Policia e Shtetit, si dhe për punonjësit e institucioneve shtetërore të pajisur me dokument identifikimi të institucionit.

Në këto orare nuk do lejohet lëvizja e lirë e qytetarëve me automjete private.

Punonjësit e Policisë së Shtetit, ata të Policisë së Burgjeve, të SHPSF-ve, personeli shëndetësor dhe gazetarët lejohen të qarkullojnë në oraret e ndërrimit të turneve, duke patur me vete dokumentim e lëshuar nga institucioni ku punojnë.

¹ Artikulli "Nga mesnata deri në orën 08.00, qytetarët u kthyen në vendbanimet e tyre (Urdhri për bllokimin e qarkullimit)", datë 15.03.2020. <https://shqiptarja.com/lajm>

² Artikulli "Urdhri për kufizimin e lëvizjes së qytetarëve, hyjnë në fuqi sot rregullat e reja. Pas mesdite Shqipëria në "shtetrrëhim", datë 20.03.2020. <https://balkanweb.com>

Automjetet e firmave prodhuese dhe furnizuese, kadet, furgonçinat, kamionçinat dhe kamionët lejohen të lëvizin në çdo moment, por duke argumentuar lëvizjen me faturat e shpërndarjes së mallit apo të furnizimit me mall.

Për urgjenca mjekësore, personat të telefonojnë në numrin 129/112 dhe në dy numrat e dedikuar, duke bërë prezent problemin për lëvizjen që kërkojnë.

Policia e Shtetit apelon për të gjithë drejtuesit e automjeteve që nuk janë të përfshirë në listën që u lejohet të qarkullojnë, të respektojnë me rigorozitet kufizimet dhe të mos dalin në qarkullim, pasi dalja i penalizon me 3 vjet të heqjes së Lejes së Drejtimit."

Pas hyrjes në fuqi të këtij akti normativ dhe Urdhrit nr. 168/1, datë 15.03.2020 "Për kufizimin e lëvizjeve brenda vendit" të Ministrisë të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale janë krijuar disa shqetësime në veçanti për drejtuesit e mjeteve të cilët duan që të lëvizin me mjetet e tyre për probleme nga më të ndryshme, si për vajtjen në vendet e punës në ato institucione apo ndërmarrje që vazhdojnë punën, për të bërë furnizimet e marketeve me produkte ushqimore, blegtorale dhe bujqësore etj.

Sipas njoftimeve që u dhanë nga media të ndryshme drejtuesit e mjeteve duhet të drejtoheshin në Drejtorinë e Policisë Rrugore pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit në numrat e telefonit 069 41 22223 dhe 069 41 22224, si dhe nëpërmjet komunikimit elektronik në adresën e dedikuar: policiarrugore@asp.gov.al, për akreditim apo për të marrë informacione të ndryshme në lidhje me masat kufizuese.

Sikurse rezultojnë nga disa burime, si informacionet e dhëna nga disa drejtues mjeteve, nga vetë strukturat e Policisë së Shtetit nëpërmjet njoftimit të cituar më sipër, nga media, si dhe nga intervistat e dhëna nga punonjës të Policisë Rrugore pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, numri i aplikimeve të drejtuesve të mjeteve që kanë bërë kërkesa për akreditim është shumë i madh dhe deri para disa ditësh ishte mbi 63 mijë³. Për shkak të numrit të lartë të aplikimeve, pjesa më e madhe e aplikuesve/kërkuesve jo vetëm që nuk ka marrë autorizimin e kërkuar po nuk kanë marrë asnjë lloj përgjigjeje nga kjo strukturë.

Gjithashtu edhe dy numrat e telefonit të vëna në dispozicion të publikut për të marrë informacion lidhur me këtë problem nga verifikimet që ne kemi bërë kanë rezultuar të padisponueshëm, pasi rezultojnë të zënë gjatë gjithë kohës.

Siç kemi konstatuar nga raportimet e medias, veprimet e ndjekura nga strukturat e Policisë së Shtetit, kanë sjellë si pasojë grumbullimin e një numri të konsiderueshëm të drejtuesve të mjeteve tek Drejtoria e Policisë së Shtetit, për të marrë informacion, apo autorizim, për lëvizjen me mjetet e tyre, ç'ka nuk ka qenë në harmoni me masat e marra për parandalimin e përhapjes së këtij virusi.

Ndërkohë ditët e fundit, janë bërë publike edhe disa shqetësime të tjera që iu janë krijuar shtetasve shqiptarë pas shpalljes së pandemisë dhe veçanërisht atyre që po kthehen nga Greqia dhe Maqedonia e Veriut në Shqipëri, nëpërmjet Pikave të Kalimit Kufitar Kakavijë, Kapshticë dhe Qafë Thanë. Shqetësimi i qytetarëve shqiptarë që po kthehen nga jashtë vendit qëndron në faktin se ata pasi hyjnë në territorin e vendit tonë, e iu nënshtrohen ekzaminimeve mjekësore për infektimin nga COVID-19 dhe pasi u këshillohet që të qëndrojnë të vetëkarantinuar për 14 ditë, mbeten në rrugë sepse nuk ka mjete transporti për të lëvizur drejt vendbanimeve përkatëse. Raste

³ Nisur nga ky numër i lartë, vlerësojmë se ndoshta jo të gjitha këto kërkesa janë të argumentuara.

të tilla janë bërë publike edhe nga TV Top Channel në datat 22.03.2020⁴, 23.03.2020⁵ dhe 24.03.2020⁶ etj.

Ne vlerësojmë se kjo mënyrë e të vepruarit duke i lënë këta shtetas pa asnjë mundësi lëvizjeje, nuk i shërben aspak qëllimit të vendosjes së masave nga autoritetet shtetërore ditët e fundit. Përveç të tjerave, kjo kategori e personave të kthyer nga jashtë vendit mund të jetë potencial si mbartës të infeksionit të COVID-19 dhe lënia e tyre jashtë kontrollit të strukturave shtetërore, mund të sjellë si pasojë përhapjen e këtij infeksioni. Në vend të futjes në karantinim të detyruar të atyre që do të rezultonin pozitiv pas ekzaminimeve mjekësore të bëra në kufi apo të futjes në vetëkarantinim për 14 ditë të të tjerëve që do të rezultonin negativ, ata lihen pa asnjë lloj kontrolli që sipas akteve normative të miratuara për këtë qëllim, është i domosdoshëm për këtë periudhë kohore që po kalojmë.

Në lidhje me aktet nënligjore të nxjerra nga Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe konkretisht Urdhrin nr. 168/1, datë 15.03.2020 “Për kufizimin e lëvizjeve brenda vendit” dhe Urdhrin nr. 193, datë 20.03.2020, “Për mbylljen apo kufizimin e lëvizjeve në Republikën e Shqipërisë”, konstatojmë se deri në momentin e hartimit të këtij Rekomandimi në datën 26.03.2020, ato nuk janë botuar në Fletoren Zyrtare.⁷

Sjellim në vëmendje se në bazë të nenit 116/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, *aktet normative të ministrave dhe të organeve drejtuese të institucioneve të tjera qendrore kanë fuqi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë brenda sferës së juridiksionit të tyre*. Ndërsa në bazë të nenit 117/1 të Kushtetutës, *ligjet, aktet normative të Këshillit të Ministrave, të ministrave, të institucioneve të tjera qendrore marrin fuqi juridike vetëm pasi botohen në Fletoren Zyrtare*. Pra, sikurse shprehet në mënyrë të qartë kjo dispozitë kushtetuese, botimi i këtyre akteve në Fletoren Zyrtare është domosdoshmëri për marrjen e fuqisë juridike.

Pavarësisht këtij detyrimi kushtetues, në fakt masat e përcaktuara nga këto dy akte normative nënligjore janë zbatuar dhe po zbatohen nga strukturat shtetërore pa e marrë fuqinë juridike për shkak se nuk janë botuar ende në Fletoren Zyrtare.

Ndërkohë kemi konstatuar se këto dy urdhra nuk gjenden të pasqyruar as në faqen zyrtare të këtij institucioni. Publiku i gjerë është informuar mbi masat kufizuese në lëvizje nga deklaratimet e Kryeministrit, njoftimet dhe masat zbatuese nga Policia e Shtetit apo media. Mospërbushja e detyrimit për publikimin e tyre, ka sjellë si pasojë që këto akte nuk kanë qenë lehtësisht të aksesueshme për të marrë një informacion të plotë dhe të saktë rreth masave të marra

⁴ Në datën 22.03.2020, në edicionet informative është ngritur shqetësimi i disa shtetasve shqiptarë, shumica nga zona e Shkodrës, të cilët kishin ardhur nga Greqia nëpërmjet PKK Kakavijë. Për shkak të mungesës së mjeteve të transportit publik/privat ata kishin ngelur në rrugë dhe nuk dinin se si do të udhëtonin për në banesat e tyre.

⁵ Në datën 23.03.2020 në emisionin “Fiks Fare” është trajtuar shqetësimi i një shtetasi nga fshati Babunjë i qytetit Lushnje. Sipas këtij shtetasi, në datën 16.03.2020 djali i tij ishte kthyer nga Maqedonia e Veriut nëpërmjet PKK Qafë Thanë dhe pasi kishte ecur në këmbë deri në fshatin Qukës të Librazhdit kishte ngelur aty sepse nuk po gjente mjete transporti për të shkuar në banesë. I ati i tij i ishte drejtuar nëpërmjet aplikimit on-line dhe marrë në telefon disa organeve të vendore të policisë të qarkut Fier, si Sektorit të Policisë Rrugore, Komisariateve të Policisë Fier, Lushnje dhe Divjakë për të marrë një autorizim për të lëvizuar me makinë me qëllim marrjen e djalit në Librazhd. Por, autorizimi nuk i jepej nga strukturat e policisë duke i thënë se raste të tilla nuk parashikoheshin në aktet e nxjerra për ndalimin e lëvizjes së mjeteve.

⁶ Në datën 24.03.2020 në edicionet informative u ngrit shqetësimi i konstatuar nga gazetarët e këtij televizioni në PKK Kapshticë, ku ishin disa dhjetëra shtetas shqiptarë të ardhur nga Greqia të cilët kishin ngelur në rrugë për shkak të mungesës së mjeteve të transportit rrugor që të lëviznin drejt vendbanimeve të tyre. Sipas gazetarit të këtij televizioni në këtë datë nga Greqia kishin hyrë 210 shtetas shqiptarë.

⁷ Ndërsa, të gjithë urdhrat e Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me nr.134-160 që u përkasin datave 09.03.2020 dhe 10.03.2020 janë publikuar në Fletoren Zyrtare në datën 25.03.2020.

dhe kufizimeve të bëra nga autoritetet përgjegjëse në vend. Madje, ka qenë e vështirë, në mos e pamundur për të marrë informacionet e duhura nga çdo kategori sociale e shoqërisë, në veçanti nga grupet e marzhinalizuara apo me aftësi ndryshe.

Me VKM nr. 243, datë 24.03.2020⁸, në Republikën e Shqipërisë për shkak të epidemisë së shkaktuar nga COVID-19 u shpall gjendja e fatkeqësisë natyrore. Ky akt normativ parashikon se organi më i lartë për koordinimin dhe bashkërendimin e veprimeve të institucioneve shtetërore dhe të subjekteve private, si dhe të burimeve financiare e materiale për përballimin e fatkeqësisë natyrore është Komiteti Ndërmintor i Emergjencave Civile. Pavarësisht këtij fakti, bazuar në pikën 7 të kësaj VKM-je të gjitha të drejtat dhe liritë e kufizuara me akte, të dala në zbatim të ligjit nr. 15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, të ndryshuar, dhe me aktin normativ nr. 3, datë 15.3.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19”, të ndryshuar, mbeten në fuqi. Kjo do të thotë që edhe dy urdhrat e trajtuar⁹ më sipër të nxjerra nga Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale janë në fuqi dhe sjellin efekte juridike.

Ndërsa për njoftimin e bërë nga Policia e Shtetit konstatohet se:

1. Ai nuk i referohet aktit mbi bazën e të cilit është vendosur orari i lëvizjes së njoftuar më sipër në mëngjes nga ora 06:00 deri 08:00 dhe në pasdite 16:00 deri në 17:00. Nëse do t'i referohemi nenit 1 të aktit normativ kuptohet se orari i lëvizjes së mjeteve duhet të bëhet me vendim, urdhër apo udhëzim të nxjerrë nga organi kompetent. Referuar ligjit nr. 15/2016 “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, rezulton se ky organ është ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Sikurse cituam më sipër, në Urdhër nr. 168/1, datë 15.03.2020 “Për kufizimin e lëvizjeve brenda vendit” të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, pika 2, qarkullimi i mjeteve lejohet në intervalet nga ora 05:00 deri në orën 08:00 dhe nga ora 16:00 deri në orën 17:00. Ndërsa Policia e Shtetit në njoftimin e bërë e ka ulur kohën e lëvizjes në mëngjes me një orë, nga ora 05:00-08:00 që është në urdhrin e cituar më sipër, në 06:00-08:00.
2. Në rrethin e subjekteve që lejohen të qarkullojnë në oraret e ndërrimit të turneve janë punonjësit e Policisë së Shtetit, ata të Policisë së Burgjeve, të SHPSF-ve, personeli shëndetësor dhe gazetarët, duke patur me vete dokumentim e lëshuar nga institucioni ku punojnë.¹⁰
3. Orientimi që bëhet në këtë sqarim për të gjithë pronarët e bizneseve prodhuese apo ata që ofrojnë shërbime për qytetarët, të cilët duan të akreditojnë automjetet për lëvizje personeli apo mallra brenda qarkut, që t'i drejtohen Sektorit të Policisë Rrugore të qarkut ku kanë vendbanimin dhe ushtrojnë aktivitetin e tyre, nuk është i qartë. Ky orientim nuk parashikon mënyrën se si do t'i drejtohen ata Sektorit të Policisë Rrugore në qarkun përkatës, pra me e-mail, telefon apo duke shkuar fizikisht në këto organe.

⁸ Me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale si dhe të Ministrit të Shtetit për Rindërtimin.

⁹ Urdhri nr. 168/1, datë 15.03.2020 “Për kufizimin e lëvizjeve brenda vendit” dhe Urdhri nr. 193, datë 20.03.2020, “Për mbylljen apo kufizimin e lëvizjeve në Republikën e Shqipërisë”.

¹⁰ Vlerësojmë se në rrethin e subjekteve mund të përfshihej edhe një kategori tjetër e personave me nevojë për të lëvizur sikurse është dhe kategoria që përmendëm më lart e shtetasve shqiptarë që kthehen nga vendet e tjera nga pikat e kalimit kufitar për të udhëtuar drejt vendbanimeve përkatëse.

4. Shërbimi i ofruar drejtuesve të mjeteve nga Drejtoria e Policisë Rrugore pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit në numrat e telefonit 069 41 22223 dhe 069 41 22224, si dhe nga email-i në adresën e dedikuar: policiarrugore@asp.gov.al, për akreditim apo për të marrë informacione të ndryshme në lidhje me masat kufizuese, pothuajse është i pamjaftueshëm, sepse sikurse përmendëm më sipër jo vetëm nuk po u ofron mundësi akreditimi apo informacion shtetasve, por nuk përmbush as detyrimin për kthimin e përgjigjes qoftë ajo edhe negative.
5. Vlen të përmendim faktin se pavarësisht miratimit ose jo të kërkesave të subjekteve aplikuese, persona juridikë apo fizikë, kthimi i përgjigjes dhe njoftimi i tyre përbën detyrim për organet e administratës publike dhe në rastin konkret të Policisë së Shtetit, detyrim i cili rrjedh nga ligji për të drejtën e informimit.

Institucioni i Avokatit të Popullit **vlerëson maksimalisht** angazhimin e autoriteteve shtetërore, veçanërisht të autoriteteve shëndetësore dhe atyre të ruajtjes së rendit dhe sigurisë publike, si dhe thekson nevojën e domosdoshme për marrjen e masave të nevojshme për garantimin e mbrojtjes së shëndetit të personave që janë në krye të detyrës për parandalimin e përhapjes së pandemisë. Gjithashtu mbeshtesim punën tepër të vështirë të forcave të rendit në këtë periudhë, dhe i përgëzojmë për përballimin deri në këtë moment të kësaj situatë tepër të vështirë.

Nga ana tjetër, kemi detyrë funksionale të fokusohemi në të drejtat e qytetarëve që janë primare dhe duhen mbrojtur, sidomos e atyre kategorive në nevojë dhe në kushte mbijetese dhe se respektimi i këtyre të drejtave nga organet e administratës publike duhet të mbikëqyret nga institucionet e pavarura.

Në këtë kuadër, vlejné për t'u përmendur edhe deklaratat e Komisioneres së Lartë të Organizatës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut znj. Michelle Bachelet, Komisioneres për të Drejtat e Njeriut në Këshillin e Europës, znj. Dunja Mijatović dhe një grupi ekspertësh të Kombeve të Bashkuara. E përbashkëta e këtyre deklaratave është se, i rekomandojnë autoriteteve shtetërore përkatëse që në masat që do ndër marrin për përballimin e pandemisë të kenë në vëmendje respektimin e të drejtave të njeriut, dhe se format e komunikimit të jenë të tilla që të arrijnë tek të gjithë njerëzit. Po ashu theksohet se transparenca dhe aksesit janë thelbësore për të nxitur besimin e publikut, dhe pjesëmarrjen e tij në menaxhimin e rrethanave aktuale.

Ne çmojmë se, pavarësisht faktit të shpalljes së gjendjes së pandemisë botërore nga Organizata Botërore e Shëndetësisë dhe të shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore me VKM nr. 243, datë 24.03.2020, të cilat sjellin si pasojë kufizimin e disa të drejtave dhe lirive të qytetarëve¹¹, aksesit në informacion dhe transparenca janë shumë të rëndësishme edhe përgjatë kësaj periudhe.

Institucioni i Avokatit të Popullit vlerëson se duhet rritur niveli i transparencës duke u dhënë mundësi qytetarëve që të kontaktojnë me institucionet që ofrojnë shërbime, qoftë në rrugë telefonike apo elektronike. Autoritetet shtetërore janë përgjegjëse për publikimin e informacionit në një gjuhë të thjeshtë e të kuptueshme. Informacioni duhet të jetë i disponueshëm edhe për pakicat kombëtare, si dhe për personat me aftësi ndryshe. Po kështu është tepër e rëndësishme që

¹¹ Kufizimi i tyre është bërë me akte të dala në zbatim të ligjit nr. 15/2016, "Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive", të ndryshuar, dhe me Aktin Normativ nr. 3, datë 15.3.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19", të ndryshuar.

informacioni të jetë i kuptueshëm për fëmijët sikurse ka këshilluar edhe UNICEF në publikimet e bëra së fundmi.

Për sa më sipër dhe me qëllim informimin e plotë dhe të saktë të qytetarëve për masat e marra nga institucionet shtetërore në zbatim të ligjit nr. 15/2016, të ndryshuar dhe të aktit normativ nr. 3, datë 15.03.2020, të ndryshuar, nëpërmjet akteve nënligjore të nxjerra prej tyre, Avokati i Popullit në vijim të kryerjes së misionit ligjor *në rolin e nxitësit të standardeve më të larta të të drejtave dhe lirive të njeriut në vend*, bazuar në nenin 63/3 të Kushtetutës ku parashikohet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”*; si dhe nenin 21/b të ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, i ndryshuar, ku parashikohet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”*,

REKOMANDOJMË:

1. Marrjen e masave të nevojshme për botimin e menjëhershëm në Fletoren Zyrtare të dy urdhrave të nxjerra nga Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe konkretisht Urdhrit nr. 168/1, datë 15.03.2020 *“Për kufizimin e lëvizjeve brenda vendit”* dhe Urdhrit nr. 193, datë 20.03.2020, *“Për mbylljen apo kufizimin e lëvizjeve në Republikën e Shqipërisë”*.

2. Marrjen e masave të menjëhershme nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për pasqyrimin në faqen zyrtare të akteve nënligjore të nxjerra për masat e marra në zbatim të ligjit nr. 15/2016, të ndryshuar dhe të akteve normative të Këshillit të Ministrave, në kuadër të marrjes së masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19.

3. Marrjen e masave të nevojshme për decentralizimin e kompetencës për dhënien e autorizimeve për lëvizjen e mjeteve, ose shtimin e personelit në Drejtorinë e Policisë Rrugore që ofron këtë shërbim apo gjetjen e mënyrave alternative të organizimit të punës.

4. Marrjen e masave të nevojshme për lejimin apo ofrimin e shërbimit të transportit në të gjitha pikat e kalimit kufitar, veçanërisht me Greqinë dhe Maqedoninë e Veriut, për të bërë të mundur lëvizjen dhe shpërndarjen në vendbanimet përkatëse, të shtetasve shqiptarë të ardhur nga këto vende përgjatë kësaj periudhe kohore.

Për qëndrimin që do të mbani ndaj këtij rekomandimi dhe masat që do të merren për zbatimin e tij, lutem të na vini në dijeni brenda afateve të përshtatshme.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

AVOKATI I POPULLIT

ERINDA BALLANCA



Konceptoi: S. Nushi

Miratoi: E. Ruspi